

S H E S T J A

THIRRTORET, T. II.

PAS IKOS TU EFRATHA, T. II.

Këndohen gjashtë, dyke përsëritur të parën:

Zoti u-ngjit në qjell, dhe ndënji më të djathtë, mi fronin pranë Atit, dhe Engjëjtë e pritnë, me bujë dhe me brohori. **(2 herë)**

Engjëjtë me lavdi, kur panë që u-ngjite, i hipur përmi retë, çuditëshin dhe thoshnin: Lavdi më ty o Zoti Krisht.

Qanin me kuj' e vaj, dishepujtë kur panë, që fluturove sipër, dhe thoshnin të përlotur: Jetimë mos na ler mi dhe.

Shpirtin Shenjt na dërgo, me Atin pa vonesë, që të na ngushëllonjë, edhe të na dhuronjë, Parajsën e Shenjtorëve.

LAVDI DHE TANI

Krisht o i ëmbël Zot, nga Mali i Ullinjve, në qjellin fluturove, dhe botës i dërgove, shpëtim dhe hir me Shpirtin Shenjt.

PAREVARGU I MBREMES, T. R.

Degjo-ma faljen o Perëndi, edhe ver-i veshin lutjes sime. (3 herë)

PASVARGJET, T. II.

PAS IKOS TU EFRATHA

Linde siç deshe ti, siç deshe u-varrose, dhe pas tri ditsh u-ngjalle, dhe lart në qjell u-ngjite, lavdi më ty o Zoti Krisht.

Ndrite kur hipe lart, me roba fjesht të kuqe, nga Kryqi dhe nga gjaku, që derdhe për shpëtimin, dhe dritën e besnikëve.

Mal' i Ullinjve ndrit, atje u-fal tri herë, atje e tradhëtuan, s' andejmi sot po ngjitet, në qjell dhe Shpirtin Shenjt na çon.

LAVDI DHE TANI

Fryni trumbeta sot, kimbale tingëllini, timpane oshëtini, mi fronin hipi Krishti, në qjell pas tij po ngjitemi.

PERLESHORJA E SHESTJES, T. IV.

Fluturove në qjellin, o Krisht Perëndi dhe Zot, dhe i gëzove dishepujtë, dyke u premtuar Shpirtin Shenjt që lartazi, dhe me bekimin që muarnë u-shiguruan, se i Bir' i Perëndisë je ti, dhe Shpëtimtar' i botës. (3 herë)

NDENJESORET

PAS TU LITHU SFRAJISTHENTOS, T.I.

Kur Engjëjtë çuditëshin për Shestjen e Shenjtë, edhe Apostujtë vajtonin, që mbetnë të shkretuar, u-ngjite me lavdi si Perëndi, dhe dyertë t' u-çeln' o Shpëtimtar; përandaj pra gjithë Forcat e qiellit, thërrisnin o Jetëdhënës: Lavdi më ty që zbritë përmi dhe, lavdi më ty që mbretëron në qjell, lavdi më ty që fluturon mi re, Zot i mëshirave.

PAS TIN OREOTITA, T. III.

I parëjetëshmi, dhe i panisuri, si Perëndi dhe Zot, zbriti në varr për ne, edhe u-ngjall edhe u-ngjit në qjell me brohori. Engjëjtë e presin pra, me gëzim dhe me ngazëllim, Apostujtë derdhin lot, se humbasin Mësonjësin; iu-falnë pra dhe thirrën me zë të math: Merr-na dhe ne o Zot pas teje.

LAVDI DHE TANI. Gjithajo.

PAS TON SINANARKHON LOGON, T.T.I.

Passi zbritë prej qjellit mi dhe për ne o Zot, dhe i ngjalle të vdekurit e burgosur në Ferr, dhe e ngrite të rrëzuarin stërgjysh Adam, lart në Parajs' o Shpëtimtar, na e shpure me lavdi, në fron e vëndose prapë, përpara Perëndisë dhe Atit, si njeridashës dhe mëshirëplot.

LAVDI DHE TANI. **Gjithajo.**

Pastaj Shkallesa Kremtore: "Që prej djalërisë."

PAREVARGU: U-ngjit Perëndia me brohori, Zoti me bujë trumbetash.

Ungjilli Mëngjesor III (Kremtore, f. 142-3), pastaj pa zë:

Passi pamë Ngjalljen e Krishtit . . .

Psalmi 51 pa zë. Pastaj:

LAVDI. Me nërmjetimet e Apostujve, o mëshirëplot, shuaji paudhësit' e mia.

TANI. Me nërmjetimet e Hyjlindëses, o mëshirëplot, shuaji paudhësit' e mia.

Mëshiro-më, o Perëndi mëshirëplot, edhe shuaji paudhësit' e mia.

T. II. Fryni trumbeta sot, kimbale tingëllini, timpane oshëtini, mi fronin hipi Krishti, në qjell pas tij po ngjitemi.

SHKURTORJA, T.T. IV.

Passi e mbarove punën për ne mi dhenë, dhe si i pajtove njerëzit me Perëndinë, fluturove në qjellin o Krisht Perëndi dhe Zot, po s' u-ndave prej dishepujve, se qëndron gjithënjë me ne, se u the me mall besnikëve: Ja unë jam me ju, dhe asnjë kundër jush.

SHTEPIA

Ejani le të zgjohemi, le t'i ngremë përpjetë sytë dhe mejtimet, le të kujtojmë që jemi në Malin e Ullinjve, që ta shohim Krishtin, që hipi mi retë, dhe fluturoj në

qjell, dhe s' andejmi u dërgoj dhuratat e pasura, dhe i ngushëlloj, dhe u tha: Nukë ndahem prej jush; unë jam me ju, dhe asnjë kundër jush.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Enjten e javes së gjashtë pas Pashkës së Madhe, kremtojmë Shestjen e Zotit edhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht.

O Krisht o Perëndia ynë, që u-shestjove me lavdi, mëshirona. Amin.

ZBRITESORET, T. IV.

THIO KALIFTHIS

- I. Mjegull e mbuloj bëlbëcakun në malin Kur e proklamoj ligjën e Perëndisë; Se e hodhi tej errësirën e mëndjes, E pa të Lartin dhe prej Shpirtit i ndriçuar Mori dijën dyke lavdëruar Zotin.
- III. Lithmën e çliroj të beronjës pa foshnjë, Talljen e pëllores me fëmijë shumë E pushoj një herë Profetesha Anna Me të falura me frymë të dërmuar Përpara Perëndisë Zotit të mëshirës.
- IV. Mbret i mbretërve dhe Bir i vetëmlindur, Fjal' e Perëndi prej Atit të panismë Shpirtin e bashkëfuqishm' e të pavdekur U dërgove Apostujve për leçitjen Dhe ata këndonin: Zot lavdi më ty.

- V. Ndjes' e paqësim për faje dhe mëkata
Prisni prej Shpirtit vesën e frymëzjartë
Bij të Kishës me fytyrë të ndriçuar,
Se tani na dolli ligja nga Siona,
Hir i Shpirtit Shenjt me gjuhëra prej zjarri.
- VI. Që të na shpëtosh e të na ndjesh mëkatat
Linde përmi dhe si Zot prej Virgjëreshës
Dhe si Profetin Shën Jona prej mushkërive
Të balenës e shpëton edhe njerinë
Të rrëzuar dhe të mbytur nga mëkatat.
- VII. Krisi me një zë një këngë me strumenta
Për adhurimin e statujës njerëzore;
Po Ngushëllimtari na ndriçon me hir
Edhe na fton të themi: O Trini e vetëm,
E shenjtë, e panisme, e bekuar je.
- VIII. Çdo zinxhir e zgjith edhe çdo flag' e shuan
I tridritëshmi simbol i Perëndisë.
Hymnojnë Djemat dhe e bekojnë Zotin,
Shpëtimtarin Krijetar si mirëbërës
Gjithë veprat që i ka krijuar vetë.
- IX. *Engjëjtë, kur panë Shestjen e Zotit, çuditëshin dhe
shtangëshim, qysh me lavdi fluturonte, që prej dheut
më të lartat.*

O Hyjlindëse Virgjëreshë dhe Nënë,
Gjuha më e mprehtë dhe oratorike
Nukë munt të të këndonjë pas vlerës,
Dhe vertikohet mëndja për lindjen tënde;
Pra me një zë të gjithë të lavdërojmë.

DERGIMESORJA, T. II

Kur të shikonin nxënësit, u-shestjove o Krisht, dhe
ndënje pranë Atit mi fronin, Engjëjtë me zë të math
thërrisnin sot: Hapini portat hapini, se Mbreti i dritës
u-kthye, në lavdin' e qëmotme. (3 herë)

LAVDERIMET, T.I.

Këndohen katër, dyke përsëritur të parën:

PAS TON URANION TAGMATON

Le ta kremtojm' o besnikë si edhe Engjëjtë, atë
që rri mi fronin, e lavdisë së Atit, me Hymnin Trishenj-
tor thërresim je Shenjt, Perëndi i panismë Zot, dhe ti o
Krisht ti o Fjalë i Shenjtë je, edhe ti o Shpirti Shenjt me
ta. (2 herë)

Fuqit' e larta të panë edhe çuditëshin, si hipe përmi
retë, dhe përpjetë u-ngjite, se dukëshe nga pamja si një
njeri, i panisuri Perëndi, i mishëruar për njerëzit përmi
dhe, pranë Atit mi fron në qjell.

Kur fluturove u-drothnë gjithë dishepujtë, në Malin
e Ullinjve, dhe vajtonin për Shestjen, po Engjëlli u thi-
rri Mos qani kot, se po kthehet i Madhi Zot, për të gjy-
kuar pa hatër çdo mëkatar, për triumfin e të drejtëve.

LAVDI DHE TANI, T. II.

Linde siç deshe ti, siç deshe u-varrose, dhe pas tri
ditsh u-ngjalle, dhe lart në qjell u-ngjite, lavdi më ty o
Zoti Krisht.

*Doksollogji e Madhe, Përlëshorja e Shestjes, pastaj nis
Mesha e Shën Joan Gojartit. Në Hyrjen këndohen:*

PERLESHORRJA E SHESTJES, T. IV

Fluturove në qjellin, o Krisht Perëndi dhe Zot, dhe i gëzove dishepujtë, dyke u premtuar Shpirtin Shenjt që lartazi, dhe me bekimin që muarnë u-shiguruan, se i Bir' i Perëndisë je ti, dhe Shpëtimtar' i botës. (3 herë)

HYRTORJA

U-ngjit Perëndia me brohori, Zoti me bujë trumbe-tash. Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që fluturove me lavdi, ne që të këndojmë Alilluia.

SHKURTORJA, T.T. IV.

Passi e mbarove punën për ne mi dhenë, dhe si i pajtove njerëzit me Perëndinë, fluturove në qjellin o Krisht Perëndi dhe Zot, po s' u-ndave prej dishepujve, se qëndron gjithënjë me ne, se u the me mall besnikëve: Ja unë jam me ju, dhe asnjë kundër jush.

Pastaj këndohet Hymni Trishenjtor. Pastaj:

APOSTULLI

Lartësohu mi qjellin, o Perëndi.

Zëmra ime është gati, o Perëndi.

Këndimi prej Akteve të Apostujve

Në shkresën e parë, o Theofil, kam folur për veprat, që bëri Jesuj, dhe për mësimet, që dha gjer në ditën që fluturoj në qjell, pasi u la Apostujve, që kishte zgjedhur, porrosira me anën e Shpirtit të Shenjtë. Përpara këtyre u-fanes i gjallë pas Pësimeve me shumë shenja, dyke u-çfaqur përpara atyre për dyzet ditë dhe dyke u

folur mi Mbretërinë e Perëndisë. Dhe një ditë, që ishin mbledhur, i porrositi të mos largohen nga Jerusalemi, po të presin zotimin e Atit, për të cilin ju kam folur. Se Joani pagëzoi me ujë, po ju do të pagëzoheni me Shpirtin e Shenjtë pas pakë ditësh që sot. Pra, kur ishin mbledhur, e pyesnin dhe i thoshnin: "O Zot, a do ta ristososh Mbretërinë e Israelit këtë herë?" Dhe ay u tha: "Nuk është puna juaj të dini kohët edhe motet, të cilat i ka në dorë Ati. Po do të merrni fuqi, kur të vinjë mi ju Shpirti i Shenjtë. Dhe do të dëshmoni për mua në Jerusalemi, dhe në tërë Judenë, dhe Samarinë, dhe gjer në fund të dheut." Edhe pasi u tha këto fjale, kur po e shikonin, u-ngrit përperjetë, edhe një re e mbuloj prej syve të tyre. Edhe tek po shikonin në qjell, ja dy burra me roba të bardha u qëndruan përpara, edhe u thanë: "Burra Galileanë, përse qëndroni aty edhe shikoni në qjell? Gjithëky Jesu, që fluturoj në qjell, do të vinjë prapë ashtu siç e patë të shkonjë përperjetë." Pastaj u-kthyen në Jerusalemi nga Mali i Ullinjve, i cili është një ditë udhë lark Jerusalemit.

UNGJILLI PAS LUKAJT

Këndohet Ungjilli Mëngjesor VI (shiko Kremtoren, f. 146-7)

Në "Veçan Tërëshenjtën" këndohet:

SE TIN IPER NUN

Ty që linde Shpëtimtarin Jesu për çudi, ty që linde në kohë Perëndin' e pakohëshme, me një zë ne besnikët madhështojmë sot.

KUNGATORJA

U-ngrit Perëndia me brohori, Zoti me bujë trumbe-
tash. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të "Pamë Dritën," këndohet:

PERLESHORJA E SHESTJES, T. IV

Fluturove në qjellin, o Krisht Perëndi dhe Zot, dhe
i gëzove dishepujtë, dyke u premtuar Shpirtin Shenjt
që lartazi, dhe me bekimin që muarnë u-shiguruan, se
i Bir' i Perëndisë je ti, dhe Shpëtimtar' i botës.

Pas Uratës Përpara Tribunës, këndohet:

Emri i Zotit qoftë i bekuar që tani dhe gjer më jetë.
(3 herë)

PERLESHIMI

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që fluturoj nga dheu
në lavdinë qjellore, dhe ndënji më të djathtën e Atit,
me nërmjetimet e Shën Marisë dhe të gjithë Shenjtorëve,
na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeri-
dashës.